

PKR.nr.600/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarëve B.G., R.G., F.A.dhe I.G.për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 nën.par.1 lidhur me par.2 dhe 1 si dhe neni 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.75-3/2010 të dt:25.05.2012, pas mbajtes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik me dt. 27.04.2018 në prezencën e prokurorës së shtetit Fitore Sadiku dhe të akuzuarëve B.G. me av. A.Gj. sipas detyrës zyrtare, R.G. me av. B.A. sipas detyrës zyrtare, F.A.me av. T.B.-B. sipas detyrës zyrtare dhe I.G.me av. A.L. sipas detyrës zyrtare dhe të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

B.G., nga i ati N., e ëma S., e gjinisë Gj., i lindur me dt: ..., në P., ku edhe jeton në rr.”A.T.” nr...., ka të kryer shkollën fillore, jo i punësuar, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R.Kosovës. me nr. personal; ...

R.G. nga i ati M., e ëma A., e gjinisë M., i lindur me dt.... në P., ku edhe jeton në rr. I.K.” nr.... i pa martuar, ka të kryer shkollën fillorë, jo i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal: ...

F.A.nga i ati I. e ëma M., e gjinisë N., i lindur me dt ..., në P., ku edhe jeton në rr. “D. e M. nr...., ka të kryer shkollën fillorë, i martuar, baba i ... fëmiu, i pa punë, i gjendjes dobët, ekonomike, Shqiptar Shtetas I Republikës së Kosovës, me nr. personal: ...

I.G.nga i ati I. ëma Sh., e gjinisë L., i lindur me dt ..., në P., ku edhe jeton në rr.”I.K.”, nr...., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, jo i punësuar, i gjendjes dobët ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal:

JANË FAJTOR

SEPSE: Me dt: 30.08.2009, rreth orës 05:00 në P., në rrugën “D. e K.”, tek rrethi i Spitalit, të pandehurit B.G., F.A., R.G. dhe I.G.me veturën e tipit ‘BMË’, me ngjyrë të zezë me targa .., të cilën e drejtonte I pandehuri R., janë ndal nga policia dhe gjatë kontrollimit brenda në veturë është gjetur një qese me peshë 22.83 gram e llojit marihuanë, kurse në trupin e të pandehurit Behar një qese marihuanë dhe letra të marihuanës, tek i pandehuri Ilir një qese e llojit marihuanë, gjithashtu edhe tek i pandehuri F.A.një qese marihuanë, të cilët duke vepruar në grup në bashkëkryerje paautorizim i kanë blerë dhe poseduar substancat narkotike të cilat janë shpallur të rrezikshme duke i transportuar, me qëllim shpërndarjeje-shitje ose ofrim për shitje për në bregdetin Shqiptar, me ç’rast nga policia është bërë konfiskimi i narkotikëve dhe letrave mbështjellëse për substance narkotike,-

- me çka kanë kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bashkëkryerje nga neni 229 par.4 nën.par.1 lidhur me par.2 dhe 1 si dhe neni 23 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve: 2,3,7,17,31,41,46,49,50,51,52,53,62,73,75,76 të KPRK-së, nenit 365 të KPPK-së.

Të akuzuarit **B.G.**, i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj**, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën kohore prej **1 (një) viti**.

Të akuzuarit **R.G.** i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj**, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën kohore prej **1 (një) viti**

Të akuzuarit **F.A.** i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj**, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën kohore prej **1 (një) viti**

Të akuzuarit **I.G.**, i shqiptoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muaj**, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën kohore prej **1 (një) viti**

Të akuzuarit **B.G.** i konfiskohet një qese marihuanë dhe letra të marihuanës, ndaj të akuzuarit **I.G.** një qese me marihuanë, dhe ndaj të akuzuarit **F.A.** një qese marihuanë, si dhe një qese me marihuanë e gjendur brenda në veturë në peshë prej 22.83 gram, dhe të njejtat duhet të asgjësohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform nenit 453 par.4 të KPPK-së Të gjithë të akuzuarit lirohen nga detyrimi i kompensimit në tërësi të shpenzimeve të procedurës në këtë çështje penale, sepse pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurve dhe personave që ai detyrohet t’i mbështetë materialisht.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP.nr.75-3/2010 të dt:25.05.2012, ndaj të akuzuarëve: B.G., R.G., F.A.dhe I.G., për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.4 nën.par.1 lidhur me par.2 dhe 1 si dhe neni 23 të KPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 26.04.2018 dhe pasi që të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, të akuzuarit kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën, nuk kanë nevojë për sçarim shtesë dhe pasi ju ipet mundësia që të pranojnë, ose mos ta pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që ju vëhet në barrë, të akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, deklarojnë se e pranonjë fajësinë për veprën penale me të cilën i ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurorja e shtetit Fitore Sadikaj pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarëve, e poashtu edhe mbrojtësit e të akuzuarëve e mbështesin pranimin e fajësisë.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurorja e shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabime faktike.

Duke marr parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 248 par.4 të KPPK-së kur kryetari i trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqiptimin e denimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësorë dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarëve dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, me dt: 27.04.2018 e shqiptoi denimin, duke marr parasysh se të akuzuarit veprën penale e kanë kryer me dashje direkte, kanë qenë të vetëdijshëm për veprimet e tyre dhe e kanë dashur kryerjen e atyre.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarve B.G., R.G., Fatos Abazi, I.G.morri si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, premtimin e të njejtëve që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra tjera penale, sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale e që gjykata nuk ka të dhëna se ndaj të njejteve është zhvilluar ndonjë procedurë penale, sjelljen e tyre korrekte në gjykatë, gjendjen e dobët ekonomike, nivelin e ulët të përgatitjes shkollore, e po ashtu edhe faktin se të njejtit kanë qenë perdorues të substancës narkotike, ndërsa që ndaj të akuzuarit F.A.po ashtu ka marrë parasysh rrethanën se i njejtë është familjar, mbajtës i familjes dhe baba i një fëmije.

Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njejtit i shpalli fajtorë dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe më të njejtën do të arrihet qellimi i denimit siç është paraparë me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues është marrur konform nenit 229 par.5 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 453 par.4 të KPPK-së, pasi që të gjithë të akuzuarit janë të papunë dhe në mungës të çfardo burimi të të ardhurve përmes të cilave do siguronin ekzistencën e tyre.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.600/13, të dt. 27.04.2018**

**Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri**

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate